

VENDIM

Nr. 27, Datë 19.11.2012

**PËR MIRATIMIN E KUADRIT TË DETYRAVE TË ZËVENDËSDEKANIT
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Senati Akademik i UART në mbledhjen e datës 19.11.2012, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe pas diskutimeve të anëtarëve, bazuar në nenin 43, 44, 50 e 56 të Statutit të Universitetit të Arteve,

VENDOSI

1. Miratimin e kuadrit të detyrave të Zëvendësdekanit në Universitetin e Arteve, si vijon:
 - i. Organizon dhe kontrollon punën mësimore e shkencore në Fakultet;
 - ii. Ndjek zbatimin e planeve mësimore;
 - iii. Organizon e kontrollon punën për botimin e librave dhe materialeve të tjera ndihmëse në procesin mësimor;
 - iv. Ndjek bashkëpunimin shkencor e artistik të Fakultetit me institucionet krijuese e shkencore dhe me shkollat e tjera të larta;
 - v. Drejton punën për hartimin e projektplanit kalendarik të procesit mësimor dhe ia paraqet Dekanit për miratim;
 - vi. Ndjek procedurat e transferimit të studentëve;
 - vii. Në mungesë të Dekanit kryen detyrat e tij.
2. Në rastet kur ka më shumë se një zëvendësdekan, Dekani i Fakultetit rregullon me urdhër shpërndarjen e detyrave dhe delegimin e kompetencave.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE